



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 770/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Burim Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Kushtrim Zuka, duke vendosur lidhur me apelet e Fadil Halili nga Ferizaji, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr.860-2021, të datës 04.03.2021, me të cilat ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHEN** të pabazuara apelet, Anr.770/2021, Anr.771/2021 dhe Anr.772/2021, të gjitha të datës 05.03.2021, të paraqitura nga Fadil Halili nga Ferizaji, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 04.03.2021, me të cilat ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet 2506D/03R, 2533D/02R dhe 2537D/01D në Komunën e Ferizajit.

## A r s y e t i m

Me datë 05.03.2021, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Fadil Halili ka paraqitur në PZAP apelet Anr.770/2021, Anr.771/2021 dhe Anr.772/2021, të datës 05.03.2021, me të cilën pretendon se në vendvotimet 2506D/03R, 2533D/02R dhe 2537D/01D në Komunën e Ferizajit, ka dyshime të bazuara se në këto vendvotime komisionerët kanë ndryshuar numrin e votave në favor të një kandidati tjetër, duke e dëmtuar parashtruesin e apelit, dhe kërkon nga PZAP-i që ta urdhëroj KQZ-në që të bëjë rinumërimin e vendvotimeve të cekura më lart.

Si dëshmi për pretendimet e tij, parashtruesi i apeleve ka bashkangjitur deklaratat e disa dëshmitarëve të cilët në deklaratat e tyre pohojnë se kanë votuar kandidatin Fadil Halili nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), si dhe kopjet e dokumenteve identifikuese të dëshmitarëve.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelet vlerësoi se:

**Apelet janë të pabazuara**

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se apelet: Anr.770/2021, Anr.771/2021 dhe Anr.772/2021, të datës 05.03.202, të cilat për nga përmbajtja janë të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i të gjitha apeleve është kandidati për deputet Fadil Halili, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), prandaj Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me të cilin përcaktohet se: “ *Me qellim të lehtësimit të apeleve, kryesuesi i panelit vendim marrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e apeleve, kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos të bëjë bashkimin e apeleve që përmbajnë në vete çështjet të ngjashme dhe se ato panele të trajtohen me një vendim*” bëri bashkimin e apeleve dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apeleve në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të parashtruesit të apeleve gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apele.

Paneli i shqyrtoi edhe deklaratat e bashkangjitura në apele nga ana e ankuesit mirëpo të njëjtat nuk janë bazë e mjaftueshme se në këto vendvotime ka pasur parregullsi. Në rastin konkret ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër pos deklaratave, duke mos bashkangjitur Formularin i Përputhjes së Rezultateve, dhe Formularin e Rezultateve të Kandidatëve. Andaj në mungesë të provave paneli vendosi që apelet e paraqitura nga Fadil Halili kandidat për deputet nga subjekti politik LDK, të refuzohen si e pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apelet e parashtruar nga Fadil Halili i subjektit politik LDK, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat..

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.770/2021 më datën 06.03.2021

**Kryesues i Panelit**

Zyhdë Haziri



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.